



## **UDHËZUES PËR PËRFSHIRJEN E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA**

## **HYRJE**

Qëllimi i këtij udhëzimi është që të orientojë institucionet shtetërore si të përfshijnë personat me aftësi të kufizuara në proceset e informimit dhe të konsultimit.

Udhëzuesi sqaron çfarë është e drejta për informim dhe konsultim, kontekstin në të cilat këto dy të drejta vendosen për komunitetin e personave me aftësi të kufizuara, jep disa përkufizime kyç pa të cilat nuk mund të sigurohet respektimi i këtyre të drejtave, jep disa shembuj të pengesave që hasin personat me aftësi të kufizuara dhe mënyrat se si mund të eliminohen ose shmangen ato, si dhe këshilla praktike për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara.

Aftësia e kufizuar është komplekse dhe shumëdimensionale. Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK) ishte një hap themelor për zbatimin e standardeve të të drejtave të komunitetit të personave me aftësi të kufizuara. KDPAK përcakton të drejtat civile, politike, sociale, ekonomike dhe kulturore, duke i risjellë ato në kontekstin e parimeve themelore për personat me aftësi të kufizuara, siç janë aksesit dhe përfshirja. KDPAK e miratuar në vitin 2006 dhe e ratifikuar nga shteti Shqiptar në vitin 2012, ka nxitur shtetet, duke përfshirë shtetin Shqiptar për të priorizuar dhe për të përfshirë aftësinë e kufizuar në programet e tij.

Aksesi në informacionin dhe pjesëmarrja në vendimarrje që lidhet me politikat e aftësisë së kufizuar ose të tjera, është vendimtar për personat me aftësi të kufizuara, për t'i mundësuar komunitetin që të kërkojë zbatimin e të drejtave.

Pa akses në informacion, personat me aftësi të kufizuara nuk mund të punojnë për adresimin e pengesave që hasin në arsim, punësim, sistemet e transportit dhe kujdesi shëndetësor. Një numër i konsiderueshëm i të rriturve dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara jetojnë në institucione rezidenciale që i izolojnë ata edhe më shumë nga jeta e përditshme. Mungesa e aksesit në informacion përforcon këtë izolim apo përjashtim, duke rënë ndesh me parime themelore, siç janë përfshirja dhe pjesëmarrja.

## **INFORMIMI**

Bazuar në KDPAK nevojiten disa ndryshime politike dhe administrative në mënyrë që personat me aftësi të kufizuara të jenë në gjendje të kërkojnë, të shkëmbejnë dhe të marrin informacionin e kërkuar ose të kenë mundësinë ta përdorin atë për të ndryshuar apo përmirësuar jetën e tyre.

Shpesh informacioni që kërkohet nga komuniteti i personave me aftësi të kufizuara nuk është i aksesueshëm.

Informacion i aksesueshëm është informacioni që paraqitet në formate të kuptueshme për personat me aftësi të kufizuara të të gjitha llojeve. Përveç formateve Braille, shkronjave të zmadhuara, përdorimit të titrave, nevojiten edhe formate sa më të thjeshtuara. Si shembull, personat me aftësi të kufizuara mendore mund të kenë nevojë për shumë mbështetje në situatat kur diskutohet heqja e zotësisë së tyre për të vepruar për shkak të aftësisë së kufizuar në mënyrë që të kenë shumë informacion, në mënyrë të kuptueshme që të drejtat, vullneti dhe

preferencat e tyre të respektohen nga të tjerët. KDPAK thekson se aftësia e kufizuar nuk duhet të përbëjë pengesë për të ushtruar të drejtat në kushte të barabarta me të tjerët. Që kjo të ndodhë, informacioni duhet të paraqitet në formate të arritshme dhe të kuptueshme edhe në situata komplekse dhe të vështira.

Ndonjëherë, personat me aftësi të kufizuara dhe organizatat që i përfaqësojnë ato nuk mund të marrin informacionin për aftësinë e kufizuara për faktin e thjeshtë sepse nuk ekziston. Në Shqipëri, si dhe në shumë vende, institucionet nuk mbledhin informacion të mjaftueshëm mbi personat me aftësi të kufizuara, informacion i cilit lejon hartimin dhe zbatimin e politikave gjithëpërfshirëse për aftësinë e kufizuar. Në kushte të tilla shpeshherë, organizatat e personave me aftësi të kufizuara apo personat vetë përballen me një luftë të gjatë vetëm për të marrë informacionin për të cilin ata kanë nevojë për të avokuar për të drejtat.

## **KONSULTIMI**

Konsultimi ka të bëjë me përfshirjen e njerëzve të prekur nga çështje apo vendime të caktuara, duke i pyetur për nevojat e tyre, duke dëgjuar pikëpamjet e tyre dhe duke iu komunikuar atyre që janë përfshirë në mënyrë të vazhdueshme në rezultatet e këtij procesi. Konsultimi ndihmon në planifikimin, shpërndarjen dhe monitorimin e shërbimeve dhe produkteve më të mira. Konsultimi duhet të bëhet pjesë e praktikave më të mira. Ai duhet të jetë sistematik dhe jo vetëm një ngjarje që ndodh herë pas here.

Mesazhi thelbësor është se cilido qoftë qëllimi i konsultimit, qoftë për të identifikuar nevojat, për të zhvilluar politika, strategji apo plane, produkte të reja ose shërbimet, ka mënyra dhe mjete të thjeshta për të siguruar një proces konsultimit të aksesueshëm për personat me aftësi të kufizuara.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup>Manual për stafin e Bashkimit Europian: Zhvillimi i programeve gjithëpërfshirëse për aftësinë e kufizuar

[https://ec.europa.eu/europeaid/sites/devco/files/guide-disability-inclusive-development-cooperation-2012\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/europeaid/sites/devco/files/guide-disability-inclusive-development-cooperation-2012_en.pdf)

## **Çfarë thotë Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara për të drejtën e informimit dhe konsultimit?**

### **Neni 21 Liria e të shprehurit dhe mendimit, dhe mundësimi i informacionit**

*Shtetet palë duhet të marrin të gjitha masat e duhura për të siguruar se personat me aftësi të kufizuara mund të ushtrojnë të drejtën e tyre të të shprehurit dhe mendimit, përfshirë lirinë për të kërkuar, marrë dhe përhapur informacionin dhe idetë në baza të barabarta me të tjerët dhe nëpërmjet të gjitha formave të komunikimit sipas zgjedhjes së tyre, siç përcaktohen në nenin 2 të kësaj konvente, si më poshtë: a) Sigurimin e informacionit të synuar për publikun e gjerë ndaj personave me aftësi të kufizuara në formate dhe teknologji të realizueshme e të përshtatshme për lloje të ndryshme të aftësisë së kufizuar në kohën e duhur dhe pa kosto shtesë; b) Pranimin dhe lehtësimin e përdorimit të gjuhës së shenjave, Braille, komunikimit shtesë dhe alternativ, dhe e të gjitha mjeteve, mënyrave dhe formave të tjera të komunikimit të realizueshme sipas zgjedhjes së personave me aftësi të kufizuara në ndërveprimet zyrtare; c) Nxitjen e subjekteve private që sigurojnë shërbime për publikun e gjerë, përfshirë dhe internetin, që të sigurojnë informacion dhe shërbime në formate të realizueshme dhe të përdorshme për personat me aftësi të kufizuara; d) Inkurajimin e masmedias, përfshirë dhe sigurimin e informacionit nëpërmjet internetit, për t'i bërë shërbimet e tyre të mundshme për personat me aftësi të kufizuara; e) Njohjen dhe promovimin e përdorimit të gjuhës së shenjave.*

### **Preambulë**

#### **KDPAK**

Duke pasur në konsideratë se **personat me aftësi të kufizuara duhet të kenë mundësinë të përfshihen aktivisht në proceset vendimmarrëse për politikatat dhe programet, përfshirë ato që kanë të bëjnë direkt me ta**

#### ***Neni 4 Detyrime të përgjithshme***

#### **KDPAK**

*Në zhvillimin dhe zbatimin e legjislacionit për zbatimin e kësaj konvente, si dhe për proceset e tjera vendimmarrëse në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me personat me aftësi të kufizuara, shtetet palë duhet të konsultojnë dhe të përfshijnë aktivisht personat me aftësi të kufizuara, përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara nëpërmjet organizatave të tyre përfaqësuese.*

## **Cilat janë disa nga hapat që institucionet shtetërore duhet të ndjekin për të siguruar që personat me aftësi të kufizuara marrin informacioni dhe konsultohen?**

Është shumë e rëndësishme të theksohet që pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara në vendimarrje, ndikon në mënyrë të drejtëpërdrejtë në përfshirjen e çështjeve të personave me aftësi të kufizuara në të gjitha vendimet e të gjitha niveleve, të cilat prekin në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose jo të drejtat e tyre. Me vendime nënkuptojmë ligje, politika, strategji dhe akte të tjera, të cilat rregullojnë çështje të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.

Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të kufizuara (KDPAK), e cila tashmë është ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar më 15 Nëntor 2012, dekretuar nga Presidenti i Republikës më 3 Dhjetor të vitit 2012, dhe pranuar ne OKB në 22 shkurt 2013, përshkohet nga fryma e gjithëpërfshirjes në politika dhe në programe të çështjeve të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.

KDPAK, ndër të tjera, vendos mbi shtetet palë detyrimin për të mbrojtur dhe për të promovuar të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në të gjithë politikat dhe programet (Neni 4, Detyrimet e Përgjithshme). Bëhet fjalë këtu për të 'përfshirë' në politika dhe programe, të cilat trajtojnë çështje të ndryshme, që parashikojnë edhe çështjet e personave me aftësi të kufizuara ose që mund të kenë efekte për këtë komunitet.

Por, ky nuk është i vetmi nen i KDPAK, i cili shtrin detyrimin për sa i takon përfshirjes së çështjeve të personave me aftësi të kufizuara në programe të ndryshme qeveritare apo programe të zhvillimit. Kështu në hapjen e KDPAK-së, pika (o) theksohet që: 'Personat me aftësi të kufizuara, duhet të kenë mundësinë për t'u përfshirë në mënyrë aktive në vendimarrjen sa u takon programeve dhe politikave që i prekin ata në mënyrë direkte'. Ky nen, është një paraprirës dhe i nenit 4, pika c, i cili bën fjalë për përfshirje faktike në të gjitha programet dhe politikat të të gjitha niveleve.

Të dyja këto të drejta, ajo e informimit dhe konsultimit, në rastin e personave me aftësi të kufizuara janë qartësisht të lidhura me aksesueshmërinë.

Këto dy të drejta themelore nuk mund të garantohen pa informacion të aksesueshëm, pa procedura apo ambiente të paaksesueshme.

Legjislacioni shqiptar garanton gjithashtu të drejtën e informimit dhe konsultimit për personat me aftësi të kufizuara:

**Ligji Nr. 119/2014 Për të Drejtën e Informimit** rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike.

Cdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet.

Cdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit.

**Ligji Nr. 146/2014 Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik** rregullon procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik të projektligjeve, projektdokumenteve strategjike kombëtare dhe vendore, si dhe politikave me interes të lartë publik. Ky ligj përcakton rregullat procedurale që duhen zbatuar për të garantuar transparencën dhe pjesëmarrjen e publikut në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse nga organet publik. Organet publike janë të detyruara të marrin të gjitha masat e nevojshme, në mënyrë që të krijojnë mundësi për pjesëmarrjen e publikut dhe të të gjitha palëve të interesuara në procesin e njoftimit e të konsultimit publik

Në vijim, disa nga përkufizimet kyç në Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara që lidhen me informimin dhe konsultimin në mënyrë të drejtëpërdrejtë:

**“Komunikim”** përfshin gjuhët, shfaqje teksti, Braille, komunikimin me prekje, printim me germë të madhe, multimedian digjitale, si dhe gjuhë të qartë, të dëgjuar dhe të shkruar, lexues dhe mënyra, mjete dhe forma komunikimi shtesë apo alternative, përfshirë informacionin digjital dhe teknologjinë e komunikimit. “Gjuha” përfshin gjuhën e folur dhe gjuhën e shenjave, si dhe forma të tjera të gjuhës jo të folur.

**“Akomodim i arsyeshëm”** do të thotë modifikim dhe rregullim i nevojshëm dhe i përshtatshëm që nuk krijon një barrë disproporcionale, që është i nevojshëm në raste të veçanta, për t’u siguruar personave me aftësi të kufizuara gëzimin dhe ushtrimin e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut me baza të barabarta me të tjerët.

**“Projektim universal”** do të thotë projektim i mallrave, mjedisit, programeve dhe shërbimeve për t’i bërë të përdorshme për të gjithë njerëzit, në masën më të madhe të mundshme, pa pasur nevojë për përshtatje apo projektim të veçantë. Projektimi universal nuk duhet të përjashtojë pajisjet ndihmese për grupe të veçanta të personave me aftësi të kufizuara, kur është e nevojshme.

**“Heqja e barrierave”** Me qëllim që të bëhet e mundur që të gjithë personat me aftësi të kufizuara të jetojnë në mënyrë të pavarur dhe të marrin pjesë plotësisht në të gjitha aspektet e jetës, shtetet palë duhet të marrin masat e duhura për të siguruar mundësimin për personat me aftësi të kufizuara, në baza të barabarta me të tjerët, në ambientet fizike, transport, informacion dhe komunikim, përfshirë dhe teknologjitë dhe sistemet e informacionit dhe komunikimit, si dhe në mjete apo shërbime të tjera të hapura apo të siguruara për publikun, si në zonat urbane dhe ato rurale. Këto masa, të cilat duhet të përfshijnë identifikimin dhe eliminimin e pengesave dhe barrierave për mundësimin, zbatohen ndër të tjera për: a) ndërtesa, rrugë, transport dhe mjete të tjera në ambiente të brendshme apo të jashtme, përfshirë shkollat, strehimin, shërbime mjekësore apo vendet e punës; b) informacion, komunikim dhe shërbime të tjera, përfshirë shërbimet elektronike dhe shërbimet e emergjencës. 2. Shtetet palë duhet gjithashtu të marrin masat e duhura: a) për të zhvilluar, shpallur dhe monitoruar implementimin e udhëzimeve dhe standardeve minimale për mundësimin e mjeteve dhe shërbimeve të hapura apo të siguruara për publikun; b) për të siguruar se subjektet private që ofrojnë mjete dhe shërbime, të cilat janë të hapura apo të siguruara për publikun, të marrin parasysh të gjitha aspektet e mundësimin për personat me aftësi të kufizuara; c) për të siguruar trajnim për pjesëmarrësit në proces lidhur me çështjet e

heqjes së barrierave që ndeshin personat me aftësi të kufizuara; d) për të siguruar në ndërtesat dhe mjete të tjera të hapura për publikun, shenja në Braille dhe në një formë lehtësisht të lexueshme dhe të kuptueshme; e) për të siguruar forma asistence të drejtpërdrejta dhe të ndërmjetme, përfshirë udhëzues, lexues dhe përkthyes profesionale të gjuhës së shenjave, për të lehtësuar hyrjen në ndërtesa dhe mjete të tjera të hapura për publikun; 8463 f) për të promovuar forma të tjera të përshtatshme asistence dhe mbështetjeje për personat me aftësi të kufizuara për të siguruar që atyre t'u mundësohet informacioni; g) për të promovuar mundësimin e informacionit të ri dhe sistemet e teknologjitë e reja të komunikimit për personat me aftësi të kufizuara, përfshirë dhe internetin; h) për të promovuar projektimin, zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e sistemeve të informacionit të mundësueshëm dhe teknologjisë së komunikimit në një fazë të hershme, në mënyrë që këto teknologji dhe sisteme të bëhen të mundshme me një kosto minimale.

## SHEMBUJ<sup>2</sup>

Për personat me dëmtime të shikimit (të plotë ose të pjesshëm)	
<b>Disa nga pengesat me të cilat ata përballen janë:</b>	Të shikuarit dhe kuptuarit e formave të mëdha, leximi i teksteve më shkronja të vogla ose teksteve të komplikuar, mungesa e orientimit në një hapësirë të re, lëvizja e sigurtë (ka mjete, karrige, tavolina, persona të tjerë përreth)
<b>Disa nga hapat që mund të ndërmerren për të siguruar aksesin:</b>	Instalimi i shiritave pedotaktile në terren si udhëzues (shirita për të verbërit) dhe pajisjeve paralajmëruese, vendosja e shenjave të përshtatura për orientim, korridore pa pengesa, sigurimi i formateve audio ose Braille.

Për personat që nuk dëgjojnë dhe/ose nuk flasin	
<b>Disa nga pengesat me</b>	Dëgjimi ose marrja e informacionit në versionin Audio, leximi i

<sup>2</sup> Manual për parlamentarët mbi Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

<https://www.un.org/development/desa/disabilities/resources/handbook-for-parliamentarians-on-the-convention-on-the-rights-of-persons-with-disabilities.html>

Përshtatur nga 'Guida për konsultim efektiv me personat me aftësi të kufizuara'

<http://nda.ie/nda-files/-Ask-Me-Guidelines-for-Effective-Consultation-with-People-with-Disabilities1.pdf>

<b>të cilat ata përballen janë:</b>	buzëve.
<b>Disa nga hapat që mund të ndërmerren për të siguruar aksesin:</b>	Kthimi i materialeve audio në vizive, përdorimi i përkthyesve të gjuhës së shenjave, titrimi i materialeve video, ndriçim i përshtatshëm i ambjenteve (i vlefshëm për leximin e buzëve por edhe për personat që kanë shikim të kufizuar, vendosja e sinjalistikës për orientimin e nevojshëm.

Për personat me aftësi të kufizuara fizike	
<b>Disa nga pengesat me të cilat ata përballen janë:</b>	Lëvizja lirisht, sipërfaqet e rrëshqitshme ose të disniveleuara, kalimi i pengesave ose ndryshimeve në nivelin (shkalla, pjerrësi), kalimi i në korridore të ngushta, arritja e objekteve në lartësi të caktuara, shikimi i kufizuar në disa lartësi, lëvizja në distanca të gjata pa pushime.
<b>Disa nga hapat që mund të ndërmerren për të siguruar aksesin:</b>	Sipërfaqe të ndryshme lehtësuese, rampa (platforma të pjerrëta), eliminimi i pengesave në rrugë, përshtatjen e objekteve dhe komandave (udhëzimeve përmes teknologjisë), dhënie e kohës mjaftueshëm pr të pushuar, parashikimin e vendosjes së objekteve në lartësi të përshtatshme ose lehtësimin për arritjen e tyre.

Për personat me aftësi të kufizuara intelektuale	
<b>Disa nga pengesat me të cilat ata përballen janë:</b>	Vështirësitë për të nxënë dhe mësuar, problem me orientim problem me kuptimin e shenjave, memorizimin e itinerareve, lëvizjen në hapësira të ndryshme.
<b>Disa nga hapat që mund të ndërmerren për të siguruar aksesin:</b>	Udhëzime të thjeshtuara, gjuhë e lehtë për t'u kuptuar, sinjalistikë e dukshme dhe me figura, hyrje të dukshme në ndërtesa për orientim të lehtë. <sup>3</sup>

<sup>3</sup>Monitorimi i Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara



## **KËSHILLA PRAKTIKE**

### **SIGURIMI I TRANSPORTIT**

Në varësi të situatës dhe llojit të konsultimit, mund të ofrohet transporti ose rimbursimi i udhëtimit. Kjo ndodh pasi transporti mund të mos jetë i aksesueshëm.

Nëse është e mundur dhe e përshtatshme, përpiquni të zhvilloni takimet sa më afër grupeve të interesit ose transportit publik.

### **KOMUNIKIMI**

Kur njoftohet ose jepet një informacion për personat me aftësi të kufizuara, është e rëndësishme që çdo informacion i rëndësishëm për procesin e konsultimit është në një sërë formatet e aksesueshme. Kjo përfshin ofrimin e të gjitha dokumenteve në formate të aksesueshme. Prandaj personat e njoftuar duhet të pyeten gjithmonë në lidhje me nevojat. Dikush mund të preferojë materialin me e-mail, dikush version të rregjistruar audio, dikush një format me shkronja të zmadhuara, sikush ne Braille, dikush mund të kërkojë përkthyesin e gjuhës së shenjave, dikush tjetër një version të thjeshtuar dhe shkurtuar.

### **BUXHETI**

Konsultimi me personat me aftësi të kufizuara mund të kërkojë disa shpenzime të shtuara. Prandaj duhet siguruar që është vendosur një zë të posaçëm në buxhet për procesin e konsultimit. Duhet marrë parasysh që personat me aftësi të kufizuara shpeshherë jetojnë vetëm prej pagesave për shkak të atësisë së kufizuar, prandaj duhet të merren masa edhe për rimbursimin e shpenzimeve ditore gjatë konsultimit.

### **KOHA**

Duhet të merret parasysh që një mbledhje mund të mos mjaftojë, pra mund të ketë nevojë për më shumë se një herë nëse është e nevojshme.

Konsultimet rekomandohen të jenë jo shumë herët në mëngjes, atëherë kur është e mundur, sepse disa persona me aftësi të kufizuara kanë nevojë për më shumë kohë për të kryer punët e përditshme dhe varen nga mbështetja e kujdestarëve. Personave duhet t'i jepet kohë e mjaftueshme për t'u përgatitur, prandaj njoftimet duhen shpërndarë në një kohë të mjaftueshme dhe përshtatshme përpara zhvillimit të konsultimit.<sup>4</sup>

---

<sup>4</sup> Përshtatur nga 'Guida për konsultim efektiv me personat me aftësi të kufizuara'